



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 959 Prot.

Tiranë, më datë 28.07.2022

VENDIM
Nr. 400, datë 28.07.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.07.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për marrjen dhe dërgimin e kampioneve nga materiali arkeologjik i zbuluar në kuadër të projektit “Tuma e Kamenicës, Monument Kulture Kategori e I-rë”, për analiza laboratorike në Laboratorin e Institutit Max – Planck, për Shkencat e Historisë Njerëzore në Leipzig, Gjermani, me aplikues dhe zhvillues z. Lorenc Bejko, Univesiteti i Tiranës, Fakulteti Histori- Filologjisë, Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore;
2. Pas përfundimit të analizave një kopje e rezultateve të depozitohen pranë IKTK-së;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR

Elva MARGARITI

